

Mënyra dhe forma e paraqitjes së Iniciativës Qytetare

1. Peticionet i drejtohen Këshillit në fomë të shkruar dhe nënshkruhen në shkresë apo në formë elektronike.
2. Peticionet që pranohen për shqyrtim me shkresë, kanë të dhënat e mëposhtme në secilën fletë të peticionit:
 - a. citimin që i drejtohet Këshilli Bashkiak Vorë,
 - b. emrin dhe mbiemrin, adresën e banimit/ punës/ studimit, adresën elektronike dhe numra e telefonisë fikse dhe celulare, si dhe nënshkrimin e parashtruesve titullin e aktit që propozohet, e cila citohen në secilën faqe të nënshkruar të peticionit dhe fillon me shprehjen “Ne të nënshkruarit me këtë peticion i kërkojmë Këshillin Bashkiak Vorë”
 - c. arsyet e paraqitjes së peticionit
 - d. bazën ligjore të peticionin
 - e. nënshkrimet e mbështetësve të peticionit, të cilat duhe të bëhen me bojë.
 - f. Deklaratën se “Të gjitha informacionet dhe nënshkrimet e peticionet janë janë të vërtet dhe të sakta”.
 - g. Numrin e faqes (p.sh. faqja 1 nga 8, faqja 2 nga 8 etj).
 - h. Çdo rrjesht me emrin, kontakte dhe nënshkrimin e nënshkruesve duhet të këte një numër.
 - i. Peticioni duhet të jetë i shkruar apo të shtypet në njërën anë të fletës A4, në letër të bardhë.
 - j. Peticioni duhet të jetë i shkruar apo shtypur qartë.
3. Peticionet mund të shoqërohet me dokumente shtesë.
4. Peticioni për tu shqyrtuar nga Këshilli/ Komisioni i Përhershëm duhet të ketë sëpaku 50 nënshkrues, përfshirë organizatorët dhe mbështetësit, që janë persona që banojnë, punojnë apo studiojnë në territorin e Bashkisë. Një peticion me më pak se 50 emra do të pranohet për shqyrtim nëse nënshkruesit përbëjnë shumicën e banorëve dhe / ose grupit të interesuar të prekura nga çështja e ngritur.

Regjistrimi dhe dorëzimi i peticionit

1. Peticionet mund t'i dërgohen Këshillit në formë të shkruar, me shkresë apo në formë elektronike.
2. Peticioni me shkresë dorëzohet dhe regjistrohet në zyrën e protokollit të Bashkisë.
3. Për zhvillimin e peticioni elektronik do të përdoret platforma elektronike e Këshillit e shfaqur në faqes zyrtare të internetit të Bashkisë.
4. Nëse parashtruesit e peticionit duan të paraqesin një peticion në një mbledhje të Këshillit, ose në një mbledhje të Komisionit të Përhershëm, peticioni duhet të regjistrohet në zyrën e protokollit të Bashkisë, apo të dorëzohet në postë jo më vonë se 15 ditë pune para datës së mbledhjes.

5. Peticioni mund t'i dorëzohet edhe një Këshilltari, i cili/a më pas e paraqitet nëpërmjet mocionit në një Mbledhje të Këshillit. Këshilltari duhet ta dorëzojë petitionin tek Sekretari së paku 15 ditë pune para mbledhjes së Këshillit ku do paraqitet petition

Procedurave të shqyrtimit dhe e miratimit të iniciativës qytetare

Dorëzimi i Peticionit për Iniciativë Qytetare dhe Pranimi

1. Parashtruesit duhet të paraqesin dhe rregjistrojnë në Bashki të gjitha seksionet e petitionit në të njëjtën kohë.
2. Parashtruesit mund të autorizojnë, me shkrim, një përfaqësues për të paraqitur petitionin në emër të tyre.

Verifikimi i Peticionit

1. Sekretari bën verifikimin e formës së petitionit, dhe nëse e vlereson në përputhje me kërkesat e formës, i përcakton një numer petitionit.
2. Sekretari njofton parashtruesin e petitionit për përfundimin e verifikimit të petitionit të propozuar, brenda pesë ditëve të punës nga data e regjistrimit të petitionit.
3. Nëse iniciativa e propozuar nuk është aprovuar, ajo duhet të paraqitet përsëri me ndryshimet e kërkuara për të vazhduar procesin të miratimit.
4. Nëse parashtruesit kërkojnë një ndryshim në dokumentin origjinal të paraqitur nga parashtruesit person kontakti i petitionit, ndryshimi do të konsiderohet një regjistrim i ri i petitionit.

Qarkullimi për Nënshkrim i Peticionit për Iniciativë Qytetare nga Mbështetësit

1. Me marrjen e njoftimit nga Sekretari se peticioni është verifikuar, parashtruesit e qarkullojnë peticion për nënshkrime të mbështetësve.
2. Nëse parashtruesit nuk arrijnë të paraqesin një peticion për iniciativë brenda dy vitesh pasi të

jetë aprovuar peticioni për qarkullim dhe nënshkrime të mbështetësve, ata duhet të riparaqesin peticionin për miratim nga Bashkia.

Konsultimi me Kryetarin e Bashkisë për Iniciativën Qytetare

Propozimet e ardhura në Këshill si iniciativë qytetare, kur kanë ndikim financiar në buxhetin e Bashkisë, shqyrtohen në Këshill, sipas rendit të ditës, dhe nuk mund të miratohen pa marrë më parë mendimin e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Mbledhja e nënshkrimit për Peticionin për Iniciativë Qytetare

jo më pak se një (1%) për qind e banorëve të Bashkisë me të drejtë vote

Verifikimi i nënshkrimeve për Peticionin për Iniciativë Qytetare

1. Drejtorja e Juridike a Bashkisë verifikon nënshkrimet e parashtruesve dhe mbështetësve dhe numrin minimal të domosdoshëm të nënshkruesve të peticionit, përpara se peticioni t'i kalojë për shqyrtim Këshillit.

2. Nëse nga verifikimi i nënshkrimeve rezulton se të gjitha nënshkrimet janë të vlefshme, dhe për këtë arsye numri i nënshkruesve është më i barabartë ose me shumë se 1% një përqind e banorëve të Bashkisë me të drejtë vote, drejtori i drejtorise juridike lëshon çertifikatën e vlefshmërisë së peticionit. Drejtori njofton me shkrim Sekretarin për çertifikimin e peticionit.

3. Nëse numri i nënshkrimeve të vlefshme është më i vogël se 1% një përqind e banorëve të Bashkisë me të drejtë vote, drejtorja juridike njofton me shkrim parashtruesin për plotësimin e numrit të nënshkrimeve, Brenda 5 diteve pune nga vleresimi. Parashtruesi i peticionit duhet të sigurojë nënshkrimet e nevojshme Brenda një periudhe jo me shumë se tre muaj.

Paraqitja e peticionit për shqyrtim në Mbledhjen e Këshillit

1. Peticioni paraqitet për shqyrtim në një mbledhje të rregullt të Këshillit Bashkiak në një mbledhje të rregullt të Këshillit të mbajtur brenda 20 ditëve nga data e lëshimit të certifikates, pasi më parë është shqyrtuar nga Komisioni i Përhershëm.
2. Parashtruesi i peticionit ftohet nga Sekretari të paraqesë kërkesën e peticionit para Këshillit. Paraqitja e përmbledhur e kërkesës së peticionit për maksimumi 15 minuta.
3. Shqyrtimi i peticionit bëhet sipas rregullave të mbledhjes së Këshillit.
4. Këshilli Bashkiak vendos për pranimin, ndryshimin apo hedhjen poshtë të kërkesës së peticionit për initiative qytetare.
5. Vendimi për pranimin apo refuzimin e iniciativës nuk merret në mbledhjen e Këshillit Bashkiak ku iniciativa prezantohet për herë të parë, përveç rastit kur me vendim të shumicës së të gjithë Këshilltarëve vlerësohet se iniciativa trajton një rast që Këshilli e vlerëson si rast emergjent.
6. Këshilli shqyrton dhe debaton iniciativën pas paraqitjes së raportit dhe propozimeve të Komisionit. Këshilli me shumicën e votave dhe brenda 90 ditëve nga depozitimi i iniciativës në Bashki, vendos pranimin e shqyrtimit të iniciativës dhe marrjen e vendimit nga Këshilli.
7. Miratimi i iniciativës qytetare bëhet me shumicën absolute të votave të të gjithë Këshilltarëve.

Seanca dëgjimore për Iniciativë Qytetare

1. Kryetari i Këshillit, fton një seancë dëgjimore publike me përfaqësues të autorizuar të banorëve që kanë nënshkruar iniciativën. Seanca organizohet nga Sekretari dhe në të marrin pjesë sëpaku Kryetari i Komisionit të Mandateve, Legjislacionit, Rregullores dhe Zgjedhjeve, Kryetari i Komisionit që mbulon fushën e iniciativës qytetare, kryetarët e Grupeve më të mëdha politike të Këshilltarëve dhe përfaqësues të drejtorisë që mbulon çështjet të cilën trajton iniciativa qytetare.

2. Mbas dëgjësës publike dhe shprehjes me shkrim të mendimit të Kryetari te Bashkisë, iniciativa shqyrtohet nga Komisioni për Mandatet, Rregullore, Çështjeve Juridike, Zgjedhjet dhe Peticioneve. Përfaqësuesit e autorizuar të grupit që ka paraqitur iniciativën ftohen në mbledhjen më të afërt të Komisionit. Anëtarët e Komisionit kanë të drejtën t’u paraqesin përfaqësuesve të petitionit pyetjet dhe komentet e tyre mbi çështjen që trajton iniciativa.

Tërheqja e Peticionit për Iniciativë Qytetare

1. Prashtruesi i petitionit mund ta tërheqë petitionin në çdo kohë përpara se Sekretari të vërtetojë se peticioni është kualifikuar për prezantim në Këshill.
2. Një nënshkrues i petitionit mund të tërheqë nënshkrimin e tij / saj duke paraqitur Sekretarit një revokim të verifikuar të nënshkrimit nga peticioni përpara pranimit të petitionit nga Sekretarit.

Privacia dhe Konfidencialiteti

1. Parashtruesit e petitionit duhet të njihet me përgjegjësitë e tyre në lidhje me mbledhjen e informacionit personal (emrat, adresën dhe nënshkrimet) e mbështetësve.
2. Parashtruesit e petitionit nuk duhet të shpërndajnë informacioni tek palë të treta, përveç se tek Këshilli Bashkiak Vorë

Adresa postare/elektronike për depozitimin e iniciativës qytetare

1. Adresa elektronike: www.bashkiavore.gov.al.
2. Adresa postare: Rr.”Unaza” nr.2, Kodi Postar: 1032, Vorë, Shqipëri.

Afatet e Shqyrtimit të Peticionit

Peticionet shqyrtohen nga Këshilli i Bashkisë brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh.

Mbajtja e takimit publik për petitionin

Kryetari i Këshillit/ Komisionit të Përkërkshëmë mund të kërkojë mbajtjen e një takimit publik në të cilin komuniteti diskuton, bashkë me Këshilltarët, apo kryetarin e fshatit / ndërlidhësin komunitar dhe punonjësit e Bashkisë, për çështjen që citon peticioni.

Veprimet e Këshillit me Peticionet

Këshilli mbas shqyrtimit të petitionit, ndërmer veprimet si më poshtë:

1. Merr vendimin apo ndërmer veprimin e kërkuar në petition
2. I shkruan parashtruesit të petitionit duke parashtruar pikëpamjet e Këshillit në lidhje me kërkesën në petition.
3. Dërgon petitionin për shqyrtimin në një komision të përhershëm të Këshillit.
4. Mban një takim me parashtruesit e petitionit për të kuptuar arsyet e dergimit të petitionit dhe mënyrën më të mirë për zgjidhur çështjen që paraqet peticioni.
5. Mban takime publike për të diskutuar çështjen e petitionit.
6. Vendos për ndërmarrjen e një hulumtimi të çështjes.

Kërkesa e Peticionit për Mbajtjen e Takime Publike

1. Një petition mund të kërkojë mbajtjen nga Këshilli të një mbledhje publike në lidhje me kërkesën bazë të petitionit.
2. Kërkesa e petitionit për mbajtjen e takimit/ve publike nuk mund të bëhet për ato raste kur Këshilli ka detyrimin ligjor (Ligji nr. 139/2015) për mbajtjen e takimeve publike.

Petition në lidhje me një çështje që është në proces këshillimi publik nga këshilli.

1. Në rastet kur Këshilli merr një petition në lidhje me një çështje që është në proces këshillimi publik nga Këshilli, shqyrtimi i petitionit do të pezullohet.

2. Nëse peticioni përfshihen automatikisht në procesin zyrtar të këshillimit publik, organizatorët e peticionit do të informohen nga Sekretari për këtë vendim të Këshillit.
3. Përveç përfshirjes në procesin zyrtar të këshillimit publik, të gjitha peticionet që kanë lidhje me çështjen e buxhetit të Bashkisë do të vihen në dispozicion në mbledhjen e Këshillit për shqyrtin e buxhetit.
4. Në rastin kur peticioni dorëzohet pasi ka kaluar afati i këshillimit publik, por para se të merret vendimi përfundimtar nga Këshilli, dhe nëse çështje specifike po diskutohet në njërin nga Komisionet e Përhershëm, organizatori person kontakti do të ftohet në mbledhjen e komisionit për të bërë prezantimin e kërkesës së peticionit.
5. Nëse çështja tashmë është shqyrtuar nga Komisionet e Përhershëm, peticioni do të merret në shqyrtimi në momentin kur Këshilli do të marrë vendim për çështjen.

Privacia dhe Konfidencialiteti

1. Parashtruesit e peticionit duhet të njihet me përgjegjësitë e tyre në lidhje me mbledhjen e informacionit personal (emrat, adresën dhe nënshkrimet) e mbështetësve.
2. Parashtruesit e peticionit nuk duhet të shpërndajnë informacioni tek palë të treta, përveç se tek Këshilli Bashkiak.

Raporti për Peticionet

1. Sekretari harton listën dhe raportin vjetor të peticioneve.
2. Raporti paraqet peticionet për të cilat është dhënë përgjigje nga Këshilli dhe ato në proces.
3. Raporti i paraqitet Këshillit në muaji tetor të atij viti, dhe mund të propozojë afate të reja përgjigjeje për peticionet në proces.
4. Raporti i paraqitet paraprakisht Komisionit të Përhershëm për Legjislacionin dhe Zgjedhjet, komision i cili i propozon Këshillit pranimin apo ndryshimin e afatave të reja të propozuara për dhënjën e përgjigjeve të peticioneve.

Ankesa ndaj përgjigjes së Këshillit për peticionin

1. Nëse organizatori/rët e peticionit nuk janë të kënaqur me përgjigjen dhe veprimin e Këshillit/ Komisionit të Përhershëm në lidhje me kërkesën e peticionit, mund t'i dërgojnë Këshillit një ankesë.

2. Ankesa duhet të paraqitet dhe do të trajtohet sipas politikës dhe procedurave të ankesave drejtuar Këshillit.

Administrimi i regjistrit të peticioneve

1. Sekretari ndërton indeksin dhe mirëmban regjistrin e peticioneve dërguar Këshillit dhe regjistrin e peticioneve për iniciativë qytetare që janë konsideruar të vlefshëm. Ky regjistër publikohet në faqene interte te bashkisë.
2. Përgjigjet e Këshillit ndaj peticioneve të iniciativave qytetare publikohen në faqen e internetit të Bashkisë.